Kronikat e Qeta

Vargjet e jetes, ne vargje pene





nga Eri Drekaj

Kronikat e Qeta

23.11.2026

Një koleksion veprash që prekin aspektet më të thella të jetës dhe ndjenjave.

Të gjitha veprat jane të disponueshme per lexim të plotë ne faqen e autorit "eridrekaj.com".

Poezitë

Dritarja e Hapur 6
Harta në Mal 7
Valixhja e Vogël 8
Rruga e Parë 9
Mbi Male 10
Nën qiell të huaj 11
Era në fytyrë 12
Rënia 13
Dhoma e bardhë 14
Ëndrra të thyera 15
Netët e gjata 16
Dora që më mban 17
Dielli i Ri 18
Hëna e Re 19
Dera e Parë 20

Dritarja e Hapur

05.11.2026

Kur shtëpia fle e heshtur - çdo natë,
unë hap dritaren dhe ne qiell shoh një yll;
më duket se kam në shpatulla krahë,
ti hap në ajër e kurrë më mos ti mbyll.

Mbi çatitë e Shkodres zbret e bukura hënë,
dhe udhët e botës më thërrasin larg;
një zemër plot guxim Zoti ma ka dhënë,
dhe çdo ëndërr të shkruar si poezi në varg.

Çdo natë vetes ja them me zë si premtim:
dua ta njoh botën, ta ndjek këtë udhëtim.
Qielli më dëgjon dhe rrugën ma bën dritë,
që ta ndjek çdo nate, ta rrëfej çdo ditë.

Harta në Mal

05.11.2026

Një ditë në mal, mes shkëmbinjve të egër,
një hartë e vjetër po shkëlqente në dritë,
e hapa, e pashë, dhe ndjeva në zemër,
diçka që s’e kish' njohur deri atë ditë.

Një pikë e kuqe gjak mes vijave ndrinte,
dhe gjoksi mu ndez, flakë si zjarr i ri;
ish' dëshira ime, që brenda meje flinte,
dhe tani u zgjua, digjet në thellësi.

E palosa hartën dhe e mbajta në gji,
si çelës të së ardhmes, si premtim të ri.
Një ditë do ta ndjek me bindje e guxim,
der'sa zjarri i kësaj pike të bëhet shtegu im.

Valixhja e Vogël

05.11.2026

Fillova me shkollën, me libra e me mësim,
ndoqa me durim çdo leksion e çdo orë;
e dija se çdo faqe ish' hap dhe synim,
që një ditë ta mbaja vetë çelësin tim në dorë.

Pastaj erdhi patenta, me besë në provim,
mbi timon dora si fëmijë më dridhej;
dhe kur e mora letrën, ndjeva një plotësim,
rruga si lumë shkëlqyes përpara më shtrihej.

Dhe bleva një motorr, të fortë të bukur shik,
të më bëhej shok, të më bëhej mik.
E mbusha valixhen e hartën e mora në gji,
u nisa të gjej pikën e kuqe - versionin tim të ri.

Rruga e Parë

05.11.2026

Ndeza motorrin e direkt e pashë nje vegim,
u nisa, dhe deren e shtëpise e lashë larg.
I vetem, por tashmë e kam marrë këtë vendim,
ti pështkruaj malet si një varg.

Në kthesat e para shkoj me kujdes ngadalë,
por zemra më thotë "jepi, mos u ndal".
Motorri më qëndron besnik si një kalë,
i etur për vrap, nga fusha në mal.

Era në fytyrë më dhuron qetësi,
dhe shpirti me gëzon mbush' me lumturi.
Horizonti hapet dhe unë buzëqesh i lirë,
"jam ai qe dua, i bukur, dhe i dëlirë".

Mbi Male

05.11.2026

Rrugën e lashë poshtë dhe në mal u ngjita,
duart e bëra akull e gishtat plot borë;
dhe kur në majë, pa frymë, mbërrita,
mu duk se e kisha gjithë botën në dorë.

Atje lart unë isha, i vetëm sa një pikë,
i vogël si një grimcë, i humbur nën qiell,
por smë mbërtheu as ankth, as drojë as frikë,
ndjeva se isha - i fortë i lirë nën diell.

Pashë botën e madhe, pashë plot bukuri,
dhe kuptova se njeriu lindet për liri.
Nuk dua të zbres poshtë, dua të qëndroj në majë,
nga pasionet e mia, askush sguxon t'më ndajë.

Nën qiell të huaj

06.11.2026

Nën qiell të huaj ndala, i hutuar,
mes zërash të panjohur, në natën e ftohtë;
por një grup njerëzish më priten si të ftuar,
dhe më bënë vend pranë zjarrit, ngrohtë.

Pa e ditur gjuhën e tyre, mësova
se buka e ndarë ka shije, e ngrohtësi;
me gjeste prekje e të qeshura, kuptova
se çdo i huaj, mund ta japë një copë mirësi.

Tani e di: bukuria e botës shtohet kur e ndan,
e çdo i huaj bëhet mik, kur në zemër e mban.
Nën qiell të huaj, shpirti ndjehet gëzuar,
frymë për frymë e trup më trup - bashkuar.

Era në fytyrë

07.11.2026

Era fytyrën, ma përkëdhel tek shpejtoj,
dhe rruga përpara - drejt vihet në rend;
pas meje mbetet qyteti ndërsa fluturoj,
e nuk më ndal asgjë, as mur dhe as peng.

Në çdo qytet te ri, më pret një dashuri,
një buzë e kuqe e ngrohtë, një fjalë një takim;
motorri nuk ndalon, nget para me furi,
duke e lënë çdo puthje, prapa, në kujtim.

Nuk di ku fle sot, a ku zgjohem nesër,
por e di që atje në qytet më pret një puthje tjetër.
Çdo puthje më ngroh, por çdo puthje është njësoj,
puthja e veçantë në fund të rrugës po më pret - shpresoj.

Rënia

10.11.2026

Çdo ditë të bardhë, frika më zvogëlohej,
e në vend të saj më rritej besim;
në çdo kthesë dinake, guximi më forcohej,
asgjë në botë s'më ndalte, as frikë as dyshim.

Çdo mëngjes me qejf, si sportist stërvitesha,
dhe ecja ime bëhej, e lehtë dhe e shpejtë;
sa i pashem dukesha, sa i fortë ndihesha,
synimi im ishte, i qartë dhe i drejt.

Derisa një ditë, kur fuqia më la,
rruga lart u ngrit, e qielli poshtë më ra.
Ne një kthesë të errët, në një kënd rrëshqita,
në krahë u dorezova, në këmbe dot më s'u ngrita.

Dhoma e bardhë

11.11.2026

Zgjohem mes mureve, kudo shoh veç bardhësi,
pa një fytyrë të njohur, dhe pa një dritare;
mbi mua tavani, shtrihet si një zbraztësi,
e nuk e di ç'më ndodhi, nuk e kujtoj fare.

Trupi im i rëndë, i palëvizur, i ngrirë,
çdo gjë është pa shpresë, dhe e ftohtë si mur;
shpirti më ndihet i lodhur, i heshtur, i mpirë,
dhe zemra më rëndon, më peshon si gur.

Edhe pse i thyer e i humbur ndjehem,
diçka më thotë qetësisht, se më i fortë do rikthehem.
Mes të bardhës pafund, me shumë shkëlqen një dritë,
e bardhë, e vogël, por e gjallë, pa frikë.

Ëndrra të thyera

12.11.2026

Mjeku hyn në dhomë, me një zë të qetë,
e më thotë se do të mbetem përgjatë i dëmtuar;
sepse disa plagë s’do të shërohen më, as vetë,
e ëndrrat e mia, të gjitha, i shoh shkatërruar.

Mbi jastëk më rrjedh pa zë një lot,
mendoj për punen, jetën, e motorrin tim;
e kuptoj se kjo peshë do të më ndjekë për gjithë-mot,
dhe e pyeta veten: a mbaroi çdo udhëtim?

Pika e kuqe e hartës tashmë u bë e zbehtë,
dhe asgjë në jetë nuk do jetë më e lehtë.
Si xham mbi dysheme, shpresat më janë thyer,
por do jem akoma i fortë, sado i zhgënjyer.

Netët e gjata

14.11.2026

Netët të gjata të ftohta i kaloj pa gjumë,
me zërin e mbytur që më ngec në fyt;
dhimbja më vjen e madhe, më zhyt porsi lum,
dhe shpesh më duket se heshtja po më mbyt.

Me këmbë e duar të thyera mundohem,
çdo hap është betejë, çdo gjest një ushtrim;
dhe sa herë që ngrihem, përsëri rrëzohem,
"ah jeta ime rinore, sa shumë po ke durim".

Nga sytë as goja s`del më asnjë fjalë,
vetëm dhimbja më zhyt si një det me valë.
Dhe ja ku prapë vjen, dhe një tjetër natë,
e errët, e vetmuar, më e ftohtë e më e gjatë.

Dora që më mban

16.11.2026

Kur hap sytë, shoh një dorë më mban,
e pranë shtratit të gjithë stok qëndrojnë;
janë familja ime që me mua dhimbjen ndan,
e që me dashuri çdo ditë ma plotësojnë.

Ndjej dorën e ngrohtë, të pandarë, të nënës,
dhe dorën e vogël të vëllait që buzëqesh;
Ndjej dorën e butë e të ëmbël të motrës,
"Falë Zotit, shpirt, je akoma mes nesh!"

Çdo ditë këto duar më ngrenë pak më lart,
e unë mbi to e mbështes gjithë dhimbjen që mbart.
Janë me mua, e asnjë çast nuk më lanë,
kura më e mirë, duke i pasë pranë.

Dielli i Ri

17.11.2026

Një mëngjes, në dhomë hyn një diell i ri,
ajër i pastër që më zbret në gjoks shumë thellë.
Filloj të marr frymë plotësisht me gjith' mushkëri,
dhe shpirti më del në fushë si nga një shpellë.

Filloj të flas, njerëzit t`i thërras me emër,
dhe zëri im, i dobët - dëgjohet fort;
fjala më del e ngrohtë nga thellë në zemër,
e ndjehem si anije lufte që kthen në port.

Filloj të ec: një hap, dhe një hap,
nga dyshemeja e ftohtë - dorën drejt jetës zgjat.
Pasi çdo ëndërr u thye, ajo prapë më fton,
jashtë, një diell i ri fort ndriçon.

Hëna e Re

20.11.2026

Tani e shoh jetën me një tjetër ngjyrë,
çdo gjë më duket më e bukur, më e plotë;
hëna e re më buzëqesh si vashëz në fytyrë,
kam ende shumë për të parë në këtë botë.

Trupi im mban ende ndonjë plagë, ndonjë defekt,
por si hëna që është e bukur dhe kur ndriçon vetëm një pjesë,
ashtu ndihem në zemer, në shpirt ndihem perfekt,
se kam besim, guxim, kam dëshire e shpresë.

Dhe si hëna e re që pas errësirës ngrihet lart,
edhe unë jam i thyer, por me kurajë çdo çast.
Nuk jam ai që isha, por ky që ka rilindur,
dua ta jetoj jetën - plotësisht dhe i bindur.

Dera e Parë

23.11.2026

Para meje qëndron, e mbyllur, një derë,
e unë, i thyer, e di: do ti shkoj der' në fund;
përpara më shtyn një fuqi, si erë,
bindem, vendosem: "s'do ndalem, do ta mund".

Netë të gjata mbi libra, çdo faqe e pamësuar,
i lodhur, edhe nga mosha, por vazhdoj me kurajë;
çdo ngjarje është një hap drejt shkollës së mbaruar,
e çdo ditë më afër drejt ngjitjes në majë.

Dita vjen; finale, në dorë mbaj këtë diplomë,
të gjithë ata që më besuan - qeshin në të njëjtën dhomë.
Dera e parë u hap, me kokën lart e kaloj,
pas saj më pret një tjetër sfidë, "më duhet të shkoj".

Kronikat e Qeta © 2026 Eri Drekaj. Çdo riprodhim pa leje është i ndaluar.